R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KUVENDI
Konferenca e Kryetarëve

V E N D I M
Nr. 12, datë 10.04.2020

PËR MIRATIMIN ME MIRËKUPTIM TË PROGRAMIT TË PUNËS SË KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16 PRILL - 30 MAJ 2020, KALENDARIT TRE JAVOR TË PUNIMEVE TË KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16 - 30 PRILL 2020 DHE GRAFIKUT TË ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE NË KOMISIONET E PËRHERSHME PARLAMENTARE ME MJETIN E KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK CISCO WEBEX

Në mbështetje të nenit 12, pika 1, nenit 26, pika 5 dhe nenit 27, pika 3 të Rregullores, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Miratohet me mirëkuptim programi i punës për periudhën 16 prill - 30 maj 2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Miratohet me mirëkuptim kalendari i punimeve të Kuvendit për periudhën 16 - 30 prill 2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Miratohet grafiku i zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve, me anë të mjeteve të komunikimit elektronik Cisco Webex, sipas datave dhe orareve të përcaktuara.

IV. Projektvendimi "Për disa shtesa në vendimin nr. 166, datë 16.12.2004 "Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë"" të ndryshuar"" i kalon seancës plenare të datës 16 prill 2020 për shqyrtim dhe miratim.

V. Programi i punës, kalendari i punimeve si dhe çdo dokument tjetër tu dërgohet deputetëve në postën elektronike të Kuvendit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Gramoz RUÇI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI